

## NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PËR EKSPERTË JO-KYÇ

**Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut"**  
**Numri i identifikimit: EuropeAid/140131/DH/SER/MK**

Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut" kërkon ekspertë me përvojë për detyra specifike që e mbështesin zbatimin e projektit. Projekti synon të mbështesë Qeverinë në përmirësimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, dhe në të njëjtën kohë të ofrojë mbështetje për organizatat e vogla dhe bazë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive të tyre operacionale të qëndrueshme.

Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Corporate & Public Management Consulting International (CPM) përmes dy komponentëve: Komponenti 1) Mbështetja e zbatimit të objektivave kryesore nga Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2018-2020) – Prioriteti I, dhe Komponenti 2) fokusim në zbatimin e mbështetjes së drejtpërdrejt në natyrë përmes Mekanizmit të Qëndrueshmërisë Civile (CRM) të përshtatur për nevojat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Programi CRM ofron mbështetje të drejtpërdrejtë fleksibile, transparente dhe të qasshme në punën e bazuar në të drejtat dhe përfitimet publike të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile.

### **PROFILET E EKSPERTËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES**

#### **1) EKSPERT I LARTË JO-KYÇ PËR REFORMËN E SISTEMIT TË FINANCIMIT SHTETËROR TË OSHC-VE**

**Inputet (kontributet):** Deri në 20 ditë pune midis prillit dhe shtatorit 2023 (një pozicion)

##### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- Diplomë universitare në financë, ekonomi, administratë publike ose në çdo fushë që ka lidhje me detyrën
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze të shkruar dhe të folur, njohja e gjuhës/gjuhëve lokale është një avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera moderimi, komunikimi dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

##### **Përvojë e përgjithshme profesionale**

- Së paku 7 vjet përvojë pune të përgjithshme profesionale në fushat përkatëse të detyrës.

##### **Përvojë specifike profesionale**

- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në fushën e financave publike;
- Eksperiencë e demonstruar në specifikat e qëndrueshmërisë financiare të OSHC-ve;
- Aftësia për të analizuar informacione komplekse nga burime të ndryshme dhe për të sintetizuar dhe formuluar përfundime.

**Përgjegjësitë:** Për t'i ofruar mbështetje ekipit të projektit AT përmes analizës së thellë të financimit shtetëror të OSHC-ve, duke ndërlidhur të dhënat ndërmjet të dhënave të Thesarit, Njesisë për bashkëpunim me OSHC-të e të dhënave të Sekretariatit të Përgjithshëm dhe të dhënave të tjera të disponueshme të OSHC-ve, të zhvillojë materiale për t'i komunikuar gjetjet publikut të gjerë, si dhe të ndërmarr ngritjen e kapaciteteve për analiza të ardhshme tek organet e administratës shtetërore përgjegjëse për bashkëpunim me OSHC-të.

#### **2) EKSPERT I LARTË JO-KYÇ PËR PËRFSHIRJEN E OSHC-VE NË POLITIKËBËRJE**

**Inputet (kontributet):** Deri në 25 ditë pune midis prillit dhe shtatorit 2023 (një pozicion)

##### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- Diplomë universitare në drejtësi, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi, administratë publike ose në çdo fushë që ka lidhje me detyrën;
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze të shkruar dhe të folur, njohja e gjuhës/gjuhëve lokale është një avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera moderimi, komunikimi dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

##### **Përvojë e përgjithshme profesionale**

- Së paku 7 vjet përvojë pune të përgjithshme profesionale në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut, dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.

##### **Përvojë specifike profesionale**

- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në fushën e integritimit në BE, administratës publike, qeverisjes, shoqërisë civile;



- Eksperiencë e demonstruar profesionale në kuadrin institucional për bashkëpunim me shoqërinë civile;
- Aftësia për të analizuar informacione komplekse nga burime të ndryshme dhe për të sintetizuar dhe formuluar përfundime.

**Përgjegjësitë:** Të ofrojë mbështetje për ekipin e projektit AT përmes përgatitjes së pasqyrës së gjendjes në lidhje me përfshirjen e OSHC-ve në politikëbërjen në nivel qendror dhe lokal; diskutimi i gjetjeve me aktorët kryesorë përmes intervistave, fokus grupeve dhe takimeve dhe përgatitja e një raporti analitik me rekomandime për avancimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikë dhe vendimmarrje në nivel qendror dhe lokal.

### **3) EKSPERT I LARTË JO-KYÇ - EKSPERT KRYESOR PËR ZBATIMIN E MEKANIZMIT TË QËNDRUESHMËRISË CIVILE (CRM)**

**Inputet (kontributet):** Deri në 60 ditë pune midis prillit dhe shtatorit 2023 (një pozicion)

#### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi ose në ndonjë fushë që ka lidhje me detyrën;
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze të shkruar dhe të folur;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

#### **Përvojë e përgjithshme profesionale**

- Së paku 7 vjet përvojë pune në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut, dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe/ose sundimi i ligjit.

#### **Përvojë specifike profesionale**

- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në menaxhim, monitorim dhe vlerësim të programeve/ projekteve të financuara nga BE; përfshirë menaxhimin financiar; zhvillimi i procedurave operacionale për menaxhimin dhe monitorimin në nivelin e projektit; raportimi;
- Të paktën 3 përvojë projekti në lidhje me veprimet monitoruese të zbatuara nga shoqëria civile, autoritetet lokale, grupet rinore;
- Përvojë e dëshmuar me qasjen e bazuar në të drejtat (RBA);
- Përvojë e dëshmuar e punës me bashkitë lokale, organizatat e shoqërisë civile, këshillat vendorë, biznesin, mediat, komunitetin e donatorëve është një aset.

**Përgjegjësitë:** Të ofrojë mbështetje për ekipin e projektit AT në mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të programit të mbështetjes në natyrë të CRM dhe të ofrojë raporte të rregullta mbi statusin e zbatimit të veprimeve CRM. Eksperti do të ndërmarrë gjithashtu një analizë të thellë dhe do të grumbullojë të gjitha mësimet e nxjerra nga zbatimi i programit të mbështetjes në natyrë të CRM.

### **4) EKSPERT I RI JO-KYÇ – EKSPERT I PROCEDURAVE TË PAJTUESHMËRISË SË MEKANIZMIT TË QËNDRUESHMËRISË CIVILE (CRM)**

**Inputet (kontributet):** Deri në 40 ditë pune midis prillit dhe shtatorit 2023 (një pozicion)

#### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- Diplomë universitare në ekonomi, financë ose në një fushë të ngjashme ose në ndonjë fushë që ka lidhje me detyrën; Në mungesë të një diplome universitare, përvojë ekuivalente profesionale prej të paktën 3 vitesh, përveç kërkesës për të paktën 3 vjet përvojë të përgjithshme profesionale.
- Njohuri të mira të rregulloreve financiare dhe buxhetore të BE-së;
- Aftësi të mira komunikimi dhe kompjuteri (komandë e Microsoft Office (Word, Excel, Power point, etj.) dhe Internet);
- Gjuha: zotërim i shkëlqyer i gjuhës angleze, maqedonase dhe/ose shqipe në të shkruar dhe të folur;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

#### **Përvojë e përgjithshme profesionale**

- Së paku 3 vjet përvojë pune në zbatimin e projektit dhe raportimin financiar dhe/ose kontabilitetin përkatës.

#### **Përvojë specifike profesionale**

- Së paku 3 vjet përvojë pune duke punuar me projekte të financuara nga BE;
- Përvojë e dëshmuar në fazat e zbatimit të projektit me hartimin e raportit;
- Përvoja në procedurat e auditimit në kuadër të projekteve të financuara nga BE-ja është një avantazh.

**Përgjegjësitë:** Eksperti i Procedurave të Pajtuëshmërisë CRM do të mbështesë ekipin e projektit AT, kryesisht TL/KE2 në aktivitetet e përditshme që lidhen me zbatimin dhe raportimin, në përputhje me dokumentet CRM dhe afatin kohor të miratuar nga AK/EUD. Për më tepër, eksperti i pajtuëshmërisë me Procedurat CRM do të ofrojë mbështetje për pikat e kontaktit të CRM dhe përfutjesit e CRM-së gjatë fazës së zbatimit të veprimeve të miratuara dhe siguron që të gjitha aktivitetet e CRM-së lidhur me shpenzimet e projektit të kryera të autorizohen dhe regjistrohen në përputhje me udhëzimet e BE-së dhe të projektit të brendshëm, duke përfshirë Formatin, përmbajtja dhe rrjedha e duhur e dokumentit nën mbikëqyrjen e TL/KE2.



**5) EKSPERTË TË RI JO-KYÇ – PIKAT FOKALE TË MEKANIZMIT TË QËNDRUESHMËRISË CIVILE (CRM) (RI-NJOFTIM)**

**Inputet (kontributet):** deri në 40 ditë pune secili ekspert nga prilli – shtatori 2023 (**disa pozicione në rajone të ndryshme të Maqedonisë së Veriut**)

**Kualifikimet dhe aftësitë**

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi ose çdo fushë që ka lidhje me detyrën;
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, maqedonase dhe/ose shqipe në të shkruar dhe të folur;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

**Përvojë e përgjithshme profesionale**

- Së paku tre (3) vite përvojë pune në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.

**Përvojë specifike profesionale**

- Së paku tre (3) vite përvojë profesionale në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile, kundër diskriminimit, të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë, gjinisë;
- Së paku një (1) përvojë projekti në lidhje me veprimet monitoruese të zbatuara nga shoqëria civile, autoritetet lokale, grupet rinore, çështjet gjinore;
- Njohuri dhe përvojë në punën me çështjet e pakicave, gjinisë, rinisë, mjedisit, marrëdhënieve ndëretnike etj.
- Përvojë e dëshmuar në fazat e zbatimit të projektit me hartimin e raportit;
- Përvojë e dëshmuar në monitorimin e projekteve, zhvillimin e matricës së monitorimit, mbledhjen e të dhënave, punën në terren, analizimin;
- Përvojë e dëshmuar e punës me bashkitë lokale, organizatat e shoqërisë civile, këshillat vendorë, biznesin, mediat, komunitetin e donatorëve është një aset;
- Aftësi të shkëlqyera planifikimi, organizative, shkrimi i procesverbaleve të takimeve, raportim;
- Përvojë në menaxhimin e granteve është avantazh.

**Përgjegjësitë:** Të ofrojë mbështetje për ekipin e projektit AT, kryesisht TL/KE2 dhe Koordinatorin CRM në aktivitetet e përditshme që lidhen me zbatimin/monitorimin e programit CRM, të ofrojë mbështetjen e ndihmës për përfituesit potencial të CRM në të gjithë vendin në procesin e kërkesës për mbështetje, gjatë fazës së zbatimit të veprimeve të miratuara dhe të sigurojë monitorimin e duhur të zbatimit të veprimeve nën drejtimin e Koordinatorit CRM dhe mbikëqyrjen nga TL/KE2.

**APLIKIMI**

Kandidatët e interesuar që plotësojnë kriteret e mësipërme, duhet të dorëzojnë një CV të formatit të BE-së në gjuhën angleze në adresat [recruitment@cpmconsulting.eu](mailto:recruitment@cpmconsulting.eu) dhe [kepuska@cpmconsulting.eu](mailto:kepuska@cpmconsulting.eu) deri më **11 prill 2023 në orën 16:00 CET, duke cekur profilin përkatës në subjekt.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen me e-mail. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

